



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT KORÇË

VENDIM Nr. 30 datë **2.04.09**

**PËR MIRATIMIN E TREGUESVE TË PROGRAMIT TË ZHVILLIMIT
EKONOMIK PËR VITIN 2009 TË SH.A “UJËSJELLËS KANALIZIME“
KORÇË**

Këshilli Bashkiak në zbatim të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, si dhe të Udhëzimit Nr. 965, datë 11.12.2007 Për zbatimin e VKM “Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellës – kanalizimeve në njësitë e qeverisjes vendore” pika V/7, pasi u njoh me mendimin e Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit dhënë me shkresë Nr. Prot. 7900/1, datë 3.12.2008, me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë Nr. 1_ mb 08/07, datë 31.10.2008 dhe pasi shqyrtoi relacionin dhe tabelat e programit të zhvillimit ekonomik për vitin 2009 dërguar me shkresë Nr. Prot. 76 datë 09.03.2009,

VENDOSI

1. Të miratojë treguesit kryesorë të programit të zhvillimit ekonomik për vitin 2009 të Sh.A “Ujësjellës Kanalizime“ Korçë si vijon:

- | | |
|-------------------------------|------------------|
| 1. Të ardhurat nga aktiviteti | 213.000.000 lekë |
| 2. Shpenzimet gjithsej | 207.710.000 lekë |

- | | |
|-------------------------------|-----------------|
| 3. Numri mesatar i punonjësve | 90 |
| 4. Fondi i pagave | 51.700.000 lekë |

Të punohet me efektivitet në drejtim të zvogëlimit të humbjeve në rrjet, arkëtimit të plotë të vlerës të ujit të faturuar si dhe për mirëadministrimin e shpenzimeve.

2. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE

Rajmonda Nase

RAJMONDA NASE

Dixhitalizuar nga Qendra ÇIP
www.infocip.org